

1. Referuar kuadrit ligjor në fuqi, a kërkohet pajisja me kartë fermeri për personat juridik?

Po, është e nevojshme që personi juridik që kryen edhe aktivitet bujqësor, të ketë një Kod Ferme, kjo edhe për rastet kur subjekti do të kërkojë të përfitoj nga Skemat Kombëtare të mbështetjes.

2. Cila është procedura që ndiqet dhe dokumentacioni që duhet të depozitohet për t'u pajisur me kartë fermeri për personat juridik?

Sikurse edhe fermeri individual, për t'u pajisur me Kartë Ferme nevojitet:

- Dokumentacioni i tokës bujqësore i cili mund të jetë një Akt i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) ose Certifikatë pronësie;
- Ose Kontratë toke me qira;
- Vërtetim nga zyra veterinare përkatëse që ka aktivitet blegtoral (nëse kryen aktivitet të tillë), kur nuk ka tokë bujqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit ose Kartës së Identitetit të administratorit ose përfaqësuesit ligjor të personit juridik;
- Plus në rastin e subjektit juridik duhet edhe ekstrakti i QKB-s ku rezulton se të paktën njëri prej aktiviteteve të regjistruara është aktiviteti bujqësor.

3. Cila është procedura që ndiqet dhe dokumentacioni që duhet të depozitohet për t'u regjistruar në Regjistrin Rajonal të Fermave për personat juridik?

Subjekti/përfaqësuesi i subjektit paraqitet në zyrën përkatëse (në nivel qarku, aty ku kryen aktivitetin) të Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor dhe paraqet dokumentat e përmendura në pikën 2 (dy) më sipër.